



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2026

VENDIM

Nr. 435, datë 26.08.2026

MBI

**MIRATIMIN E PAGËS REFERUESE BAZË TË MAGJISTRATIT (GJYQTAR), SIPAS
VENDIMIT NR. 15, DATË 17.02.2026 TË GJYKATËS KUSHTETUESE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 25.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, ligjit nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", VKM-së nr. 325/2023, të ndryshuar, vendimit nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimit nr. 15, datë 17.02.2026, të Gjykatës Kushtetuese, dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Të miratojë pagën referuese bazë për magjistratin (gjyqtar), sipas arsyetimit të vendimit nr. 15/2026 dhe vendimit nr. 35/2022, të Gjykatës Kushtetuese, referuar përcaktimeve në VKM-në nr. 325/2023, të ndryshuar, kategoria e lartë drejtuese "Kategoria I", klasa e pagës "Klasa 1-2", të përbërë nga paga për pozicion (në shumën 222,425 lekë, sipas klasës) plus shtesa e nivelit të kualifikimit "Grupi i diplomës 1" (në shumën 14.000 lekë), për periudhën nga data 01 gusht 2026 e në vazhdim.
2. Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit dhe njësitë përgjegjëse për buxhetin në gjykatat e të tre niveleve, të bëjnë një analizë të plotë të situatës buxhetore në shpenzime personeli për vitin 2026 si dhe të fillojnë pagesën e pagave për periudhën nga data 1 gusht 2026 e në vazhdim, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi.
3. Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit dhe njësitë përgjegjëse për buxhetin në gjykatat e të tre niveleve, të përllogarisin efektin financiar të zbatimit të pikës 1 të këtij vendimi dhe në rast të nevojave për fonde buxhetore shtesë në shpenzime personeli për vitin 2026, të

kërkohet pranë Ministrisë së Financave alokimi i këtyre fondeve, sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.

4. Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit dhe njësitë përgjegjëse për buxhetin në gjykatat e të tre niveleve, të përlllogarisin efektin financiar të rillogaritjes së pagës referuese bazë për të gjitha funksionet gjyqësore për periudhën 01 prill 2023 deri në 31 korrik 2026, sipas VKM-së nr. 325/2023, të ndryshuar.

5. Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit të ndjekë procedurat sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor, për të kërkuar sigurimin e fondeve buxhetore shtesë në shpenzime personeli, pranë Ministrisë së Financave, shtrirë në dy vite buxhetore, vitin 2027 dhe vitin 2028, për kryerjen e pagesave të diferencave të pagës pas rillogaritjes së pagës referuese bazë, sipas përcaktimeve në pikën 1 dhe pikën 4 të këtij vendimi.

6. Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, për përgatitjen e dokumentit përfundimtar të PBA 2027-2029, faza e dytë, të hartojë kërkesat buxhetore në shpenzime personeli për të gjitha funksionet gjyqësore bazuar në pagën referuese bazë të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

7. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR